

## All-llahu nuk është sikur krijesat e Tij

Ngjashëm me mënyrën se si Islami ndalon atribimin e cilësive hyjnore të All-llahut krijesave të Tij, Islami gjithashtu e kundërshton idenë e atribimit të cilësive dhe kualiteteve të njeriut All-llahut.

Islami e bën një dallim të qartë midis papërkryeshmërisë së krijesave dhe përkryeshmërisë së All-llahut. Ai është shumë më lartë se çka krijesat e Tij i kanë përshkruar Atij. Disa fe megjithatë

besojnë se All-llahu hyri në trup të njeriut dhe u bë në formë të njeriut dhe se njëkohësisht ishte plotësisht Perëndi dhe plotësisht njeri.

*“Ne krijuam qiejt e tokën dhe gjithçka ka ndërmjet tyre brenda gjashtë ditësh dhe ne nuk ndiem lodhje.”*

*Kur'an 50:38*

Ne duhet të kemi parasysh se Zoti i ka atributet e përsosmërisë të tilla si i Gjithëdijshëm, i Plotfuqishëm dhe i Pavdekshëm. Njeriu megjithatë, ka atributet e papërsosura. Njeriu ka njohuri të kufizuar, fuqia e tij është e kufizuar dhe është i vdekshëm.

Muslimanët janë të ruajtur nga detyrimi për të menduar mbi këtë koncept të palogjikshëm (se Perëndia u bë njeri ose çfarëdo krijesë tjetër e Tij), për shkak të konceptit të pastër dhe të plotë Islam për Zotin.

## All-llahu adhurohet Direkt

### (pa ndërmjetësues)

Nuk ka asgjë për të parandaluar një person të lidhet drejtpërdrejt me All-llahun dhe të kërkojë ndihmën dhe faljen e Tij.

All-llahu dëgjon të gjithë ata që e adhurojnë Atë dhe i luten Atij. Nuk ka “ndërmjetësues” në Islam, të gjithë kanë qasje të pandërprerë dhe direkte tek Zoti.

Muslimanët janë të detyruar të mbajnë një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me Zotin. Adhurimi i All-llahut në mënyrë indirekte (p.sh. nëpërmjet një idhulli, statuje apo ndërmjetësues të tjerë) shihet si kompromis në Njëshmërinë e All-llahut dhe ndotje e pastërtisë së adhurimit që All-llahu e meriton.

*“Kujdes! Adhurim i sinqertë është vetëm ai për All-llahun! Ndërsa ata që në vend të Tij adhurojnë miq të tjerë (duke thënë): “Ne nuk i adhurojmë ata për tjetër, vetëm që të na afrojnë sa më afër All-llahut ...” E, është e vërtetë se All-llahu nuk udhëzon në rrugë të drejtë atë që është rrenës, jobesimtar.”*

*Kur'an 39:3*

## Të gjithë pejgamberët thirrën në Njëshmërinë e All-llahut

*Ne dërguam të dërguar në çdo popull që t'u thonë: “Adhuroni vetëm All-llahun, e largojuni djajve (adhurimit të tyre!)” Kur'an 16:36*

Muslimanët besojnë në të gjithë pejgamberët që All-llahu i dërgoi në çdo komb. Ata të gjithë erdhën me të njëjtin mesazh - Njëshmërinë e Zotit. Më poshtë shohim disa shembuj:

Nuhi (paqja qoftë mbi të) tha (Kur'an 7:59),

**“O populli im, adhurojeni All-llahun, nuk keni zot tjetër pos Tij.”**

Ibrahimi (paqja qoftë mbi të) tha (Kur'an 21:66),

**“A po adhuroni pra në vend të All-llahut asish që nuk ju sjellin kurrfarë dobie as dëmi?”**

Musai (paqja qoftë mbi të) tha (Kur'an 7:140),

**“Mos deshët, pos All-llahut, të kërkoj për ju zot tjetër, kurse Ai ju vlerësoi mbi njerëzit e tjerë?”**

Isai (paqja qoftë mbi të) tha (Kur'an 43:64),

**“S'ka dyshim se All-llahu është Ai, Zoti im dhe Zoti juaj, andaj Atë adhurojeni! Kjo është rruga e drejtë!”**

Muhammedi (paqja qoftë mbi të) ishte i urdhëruar të thotë (Kur'an 18:110),

**“Unë jam vetëm njeri, sikurse edhe ju, mua më shpallet se vetëm një Zot është Zoti juaj, e kush është që e shpreson takimin e Zotit të vet, le të bëjë vepër të mirë, e në adhurimin ndaj Zotit të tij të mos e përziejë askë.”**

Themeli i besimit Islam është besimi në Njëshmërinë dhe Veçanëshmërinë e Zotit të Plotfuqishëm, dhe siç e kemi parë, Islami hedh poshtë çdo koncept i cili çon në mohimin e njëshmërisë së All-llahut. Ekziston Një Zot, dhe nuk ka askush të drejtë të adhurohet pos Tij.

# Njëshmëria e Zotit në Islam

“Thuj: Ai, All-llahu, është Një. All-llahu është Ai që çdo krijesë i drejtohet (i mbështetet) për çdo nevojë. As s'ka lindur kë e as nuk është i lindur. Dhe askush nuk i është i barabartë me Te.”

*Kur'an 112:1-4*

### Informacion

tel 045 633 370 web islamifejaevvertete.com @ broshurat@gmail.com

Emri i bankës Pro Credit Bank

Kontoja 1184001037000102 Swift MBKORS22

gjërat  
themelore

islamifejaevvertete.com

Njëshmëria e

# Zotit në Islam

Mësimi i njëshmërisë së plotë të Zotit është thelbi i Islamit. Të gjitha ligjet e tjera, besimet dhe urdhëresat e Islamit janë ndërtuar mbi këtë themel. Po e largove këtë atëherë nuk ka mbetur asgjë nga feja.

## Emri i Zotit është atribut i veçantë

“All-llah” është emri i duhur dhe personal që e mban Zoti i Vetëm dhe i Vërtetë. Asgjë tjetër nuk mund të quhet All-llah. Termi nuk ka shumë apo gjini ndryshe nga fjala shqipe “Perëndia”, që mund të bëhet edhe në shumë edhe në gjininë femërore (dmth. perënditë / perëndeshë).

Përdorim i veçantë i fjalës “All-llah” si një emër personal i Perëndisë është një refleksion i theksit të veçantë që i vë Islami besimit në një Zot të vetëm.

## Nuk ka Zot Tjetër përveç All-llahut

*Zoti juaj (që meriton adhurim) është Një, All-llahu, nuk ka zot pos Atij. Kur'an 2:163*

Njëshmëria e Zotit në Islam është një mësim gjithëpërfshirës dhe mund të kuptohet mëtej përmestributeve të All-llahut në vijim:

- All-llahu nuk ka partnerë, nuk ka të barabartë dhe nuk ka rivalë
- All-llahu nuk ka baba, nënë, djem, vajza apo gra
- All-llahu adhurohet direkt pa askënd apo asgjë duke vepruar si një ndërmjetës
- All-llahu nuk ka nevojë për adhurimin e askujt
- All-llahu nuk i jep përgjegjësi askujt
- All-llahu nuk është i varur nga asnjë person apo gjë, por të gjithë personat dhe gjërat janë të varur nga Ai
- All-llahu krijoi çdo gjë, pa asnjë ndihmë
- Nuk ka asgjë më të lartë ose të krahasueshëm me All-llahun
- Nuk ka asgjë që ekziston përveç se është plotësisht i nënshtruar ndaj Tij

- Askush nuk mund të ndalojë atë që All-llahu jep dhe askush nuk mund të jep atë që All-llahu ndalon
- All-llahu është i Vetmi, Ai i cili mund t'i sjellë dikujt dobi apo dëm

## Nuk ka asgjë që është e barabartë me All-llahun

*O ju dy shokët e mi të burgut, a është më mirë të adhurohen zota të ndryshëm ose All-llahu, i vetmi ngadhënjimtar? Kur'an 12:39*

Muslimanët besojnë se ekzistenca e Një Zoti të Vërtetë, Unik, Suprem, të Plotfuqishëm, është i vetmi koncept logjik i Zotit. Nuk mund të ketë, për shembull, dy Krijues Absolut të fuqishëm dhe mendimi i momentit tregon se kjo nuk është e realizueshme.

Nëse do të ishte të jetë se ka më shumë se një Zot, me siguri kjo do të çonte në konfuzion, çrregullim, kaos dhe shkatërrim në gjithësi. Universi megjithatë, është në harmoni të plotë. Kur'ani përmbledh këtë në ajetin vijues:

*“All-llahu nuk ka marrë për Vete kurrfarë fëmijë (as nga engjëjt, e as nga njerëzit), nuk ka me Të ndonjë zot tjetër, pse (sikur të kishte zot tjetër), atëherë secili zot do të veçohet me atë që ka krijuar, e do të dominonin njëri mbi tjetrin! I lartë, i pastër është All-llahu nga ato që ia përshkruajnë.”  
Kur'an 23:91*

## Vetëm All-llahu meriton të adhurohet

*Adhurojeni All-llahun e mos i shoqëroni Atij asnjë send.  
Kur'an 4:36*

Nga pikëpamja islame, besimi në Njëshmërinë e Zotit do të thotë që të kuptosh se të gjitha lutjet dhe aktet e adhurimit duhet të jenë ekskluzivisht për Zotin.

Askush nuk ka të drejtë të thirret, të lutet, apo të betohet në emrin e tij dhe të falet për të, por vetëm Zoti i ka këto të drejta. Asgjë tjetër nuk është e denjë për adhurim pos Zotit: as statujat, as kryqet, as varret, as dielli, as hëna, as yjet, as tempujt, as kafshët, as profetët, as të dërguarit, as shenjtorët, as priftërinjtë apo teologët fetarë. Të gjitha këto gjëra janë të krijuara dhe të kufizuara, kështuqë janë të papërkryera- ata nuk janë të denja për adhurim në Islam, ndërsa All-llahu është i përsosur.

Kur'ani na kujton tradhtitë (mashttrimet) e të gjithë zotëve të supozuar si vijon:

*“A adhuroni atë që vetë e keni gdhendur? E All-llahu ju krijoi juve edhe atë që e punoni.”  
Kur'an 37:95-96*

*“S'ka dyshim se ata që po i adhuroni ju pos All-llahut, janë të krijuar sikur ju (njerëzit janë më të përsosur).”  
Kur'an 7:194*

## Krijesat nuk i posedojnë cilësitë e përkryera të All-llahut

*Dhe Atij askush nuk i është i barabartë. - Kur'an 112:4*

Islami mëson se asnjë pjesë e All-llahut nuk është e pranishme në dikënd apo diçka (edhe pse dituria e Tij ka përfshirë çdo gjë). Ideja e ndonjë objekti të krijuar ose qenie që të posedojë ndonjë prejtributeve të përsosura të All-llahut është plotësisht e refuzuar në Islam. Për ti dhënë krijesës atributet ose kompetencat që i takojnë dhe i përshtaten vetëm Krijuesit është që të lartësohet krijesa në një nivel të partneritetit me Krijuesin.

Për shembull, besimi në idhuj (statuja), në hajmalë dhe bestytini, të tilla si syri i mësyshit, patkua dhe numri 13, të kenë mundësi të sjellin dobi apo dëm është pa dyshim t'i bësh ortak (partneritet) All-llahut. Kjo është për shkak se vetëm Ai është i Plotfuqishëm, prandaj vetëm Ai është në gjendje të dëmtojë ose të shërojë:

Shembuj të tjerë përfshijnë falltorët dhe astrologjinë. Kushdo që pretendon se e di të ardhmen, është duke

*“Çelësat e fshehtësive janë vetëm te Ai, atë (fshehtësinë) nuk e di kush pos Tij.”  
Kur'an 6:59*

i atribuar vetës një nga atributet e All-llahut, pra vetëm Ai di të fshehtën dhe gjërat e fshehura.

*“Dhe mos lut tjetërkë pos All-llahut, ndonjë (idhull) që nuk të sjellë as dobi as dëm, e nëse e bën atë dije se i ke bërë të padrejtë vetvetes.”  
Kur'an 10:106*